



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2025

ME ZGJEDHJE – SESIONI I

Skemë vlerësimi

Lënda: Histori

24 qershor 2025

Varianti A

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	D	C	B	A	C	B	C	A	D	D
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Alternativa e saktë	D	C	B	D	D	C	A	D	C	A

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Pyetja 21 3 pikë

Model përgjigjeje:

Karakteristika	Athina	Sparta
Sistemi politik	Demokraci direkte	Oligarki ushtarake
Roli i qytetarëve	Qytetarët merrnin pjesë në vendimmarrje	Vendimmarrja e kufizuar për elitën
Ndikimi në shoqëri	Shoqëri e hapur, zhvillim kulturor	Shoqëri e disiplinuar dhe ushtarake

- 3 pikë Nëse krahason qeverisjen e Athinës me atë të Spartës në drejtim të sistemit politik, rolit të qytetarëve dhe ndikimit në shoqëri.
- 2 pikë Nëse krahason rolin e qytetarëve dhe ndikimin në shoqëri OSE rolin e qytetarëve dhe sistemin politik OSE ndikimin në shoqëri dhe sistemin politik
- 1 pikë Nëse krahason rolin e qytetarëve OSE ndikimin në shoqëri OSE sistemin politik.
- 0 pikë Nëse përgjigjet janë gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 3 pikë

Model përgjigjeje

- Territori/ kufijtë.
- Drejtuesi/ princi.
- Forma e qeverisjes.
- Arka shtetërore.
- Marrëdhëniet diplomatike.
- Kryeqendra.
- Administrata.
- Simbolet (vula, monedha, stema, flamuri).
- Noterë, kancelari.

3 pikë Nëse liston tre nga elementët shtetërorë të principatave mesjetare.

2.pikë Nëse liston dy nga elementët shtetërorë të principatave mesjetare.

1 pikë Nëse liston një nga elementët shtetërorë të principatave mesjetare.

0 pikë Nëse liston gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 3 pikë

Model përgjigjeje

- Një ndër shkaqet e emigrimit të popullsisë arbërore kryesisht në vendet fqinje gjatë shekujve XIV-XV ishte nga presioni i ushtrive serbe që zbrisnin nga veriu.
- Tjetër shkak ishte humbja e pozitave dhe funksioneve shtetërore që kishin gëzuar deri më tani, kjo si pasojë e fushatave ndëshkuese të perandorit bizantin Andronik III, në kuadrin e masave të marra për shtypjen e kryengritjeve në zonën e Vlorës dhe Beratit.
- Premtimet nga vendet fqinje, se do t'u jepeshin toka dhe kullota dhe do përjashtoheshin nga taksat. I vetmi kusht, në këmbim të këtyre privilegjeve ishte shërbimi i detyruar ushtarak nga ana e emigrantëve.
- Prania e ushtrive osmane dhe pushtimi i Shkodrës (1479) nxitën valën e emigrimeve në shekullin XV, nga frika e hakmarrjes osmane kundrejt shqiptarëve të angazhuar në luftë kundër tyre.

3 pikë Nëse përcakton tre nga shkaqet e emigrimeve shqiptare në shekujt XIV-XV.

2 pikë Nëse përcakton dy nga shkaqet e emigrimeve shqiptare në shekujt XIV-XV.

1 pikë Nëse përcakton një nga shkaqet e emigrimeve shqiptare në shekujt XIV-XV.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 3 pikë

Model përgjigjeje

- Shtresa e parë e shoqërisë që përbëhej nga kleri e fisnikëria gëzonin të gjitha privilegjet e shoqërisë
- Shtresat e larta të shoqërisë, kleri dhe fisnikëria, mbanin poste të larta administrative dhe ushtarake. Roli i tyre ishte me rëndësi gjatë sundimit absolutist të Luigjit XVI.
- Kleri e fisnikëria zotëronin pasuri të shumta dhe privilegje sepse nuk paguanin taksa. Shtresa e tretë e shoqërisë që përbëhej nga klasa e mesme ose borgjezia, paguanin taksa e detyrime.

3 pikë Nëse rendit tre argumente në mbështetje të pohimit.

2 pikë Nëse rendit dy argumente në mbështetje të pohimit.

1 pikë Nëse rendit një nga argumentet në mbështetje të pohimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25

3 pikë

Model përgjigjeje

- Rreziku i copëtimit të trojeve shqiptare bëri që shumë qytete të Shqipërisë t'i dërgonin memorandumet Kongresit të Berlinit, ku t'i kërkonin Evropës që dhe shqiptarët t'i njihnin për shqiptarë, pra si komb më vete. B.Lidhja kishte disa qendra ndërkrahinore: Janinë, Prevezë, Dibër, Elbasan, Shkodër.
- Nga ky moment çështja shqiptare nuk do ishte një çështje e brendshme e Perandorisë Osmane.Ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare e morën përsipër krerët politikë të Lidhjes, Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali Vrioni.
- Ata të mbështetur nga misionet diplomatike osmane ndërmorën një mision diplomatik për ta bërë të njohur çështjen shqiptare në kancelaritë më të rëndësishme të Evropës. Vizituan Romën, Parisin , Londrën dhe Vjenën.
- Qysh nga ai moment çështja shqiptare hyri si problem i ndërkombëtarizuar nëpër kancelaritë e Fuqive të Mëdha.
- Nëse më parë shqiptarët e njihnin diplomatikisht Evropën përmes Stambollit, Lidhja e Prizrenit realizoi kontaktet - para të drejtpërdrejta zyrtare mes përfaqësuesve shqiptarë dhe kryeqyteteve evropiane.
- Lidhja përpunoi një platformë kombëtare me kërkesa politike, ekonomike dhe kulturore përdori të gjitha format luftës çlirimtare si: kuvendet, protestat politike, misionet diplomatike, luftën e armatosur dhe veprimtarinë kulturore.

3 pikë Nëse evidenton tre nga rrugët që ndoqi Lidhja Shqiptare e Prizrenit për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare.

2 pikë Nëse evidenton dy nga rrugët që ndoqi Lidhja Shqiptare e Prizrenit për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare.

1 pikë Nëse evidenton një nga rrugët që ndoqi Lidhja Shqiptare e Prizrenit për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26

3 pikë

Model përgjigjeje

- Ekonomia ishte e planifikuar dhe zhvillohej mbi bazën e planeve 5-vjeçare.
- Forma ligjore e pronësisë ishte prona shtetërore dhe prona kolektive. U eliminua prona private.
- Prioritet mori industria e rëndë.
- Në fshat u krijuan kooperativat si prona kolektive të kontrolluara nga shteti.

3 pikë Nëse liston tre nga tiparet e ekonomisë së centralizuar.

2 pikë Nëse liston dy nga tiparet e ekonomisë së centralizuar.

1 pikë Nëse liston një nga tiparet e ekonomisë së centralizuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 27

3 pikë

Model përgjigjeje

- Ahmet Zogu kishte kohë që shfaqte prirjet e veta për të qenë monark të cilat i tregoi edhe në kohën e republikës me kompetencat e gjera që gëzonte.
- Në elitën politike shqiptare mbizotëronte prirja monarkiste dhe kjo do të ishte e pëlqyeshme nga këto segmente të elitës.
- Në vend kishte trazira politike të cilat ai do të mund ti menaxhonte më mirë nëse do të ishte mbret. Ndërsa republika nuk garantonte sigurinë e nevojshme për një shtet të ri .
- Si president ,edhe pse me mandat të gjatë 7 vjeçar, do të vinte koha të bëheshin zgjedhjet dhe mund të humbiste pushtetin.
- Vendosjen e monarkisë e mbështeti edhe Italia e cila kishte interes që Ahmet Zogu të qëndronte gjatë në pushtet pasi kishte firmosur një sërë marrëveshjesh ekonomike e politiko-ushtarake dhe priste rezultatet e tyre.
- Edhe fuqitë e tjera nuk do të shfaqnin probleme sepse ato vetë ishin gjithashtu monarki dhe një monarki parlamentare nuk e eliminon demokracinë .

3 pikë	Nëse rendit tre nga arsyet për të cilat Ahmet Zogui ndryshoi formën e qeverisjes.
2 pikë	Nëse rendit dy nga arsyet për të cilat Ahmet Zogu ndryshoi formën e qeverisjes.
1 pikë	Nëse rendit një nga arsyet për të cilat Ahmet Zogu ndryshoi formën e qeverisjes.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 3 pikë

Model përgjigjeje

- Partitë dhe organizatat sindikaliste jofashiste u shpërndanë.
- U ndalua liria e shtypit, e fjalës dhe e veprimit. Dhe u vendos censura e rreptë për çdo gjë që shkruhej.
- U krijua "gjykata speciale" për të gjykuar krimet ndaj shtetit.
- U zëvendësuan institucionet e shtetit me institucionet fashiste.
- U ndryshua kushtetuta: drejtuesi i qeverisë nuk jepte llogari për veprimet e tij përpara parlamentit.
- U eliminua votimi i përgjithshëm, duke vendosur parimin e votës mbi bazën e taksave që paguheshin për shtetin.
- U krijua policia sekrete të quajtur "Ovra", e cila kontrollonte dhe ndëshkonte çdo kundërshtar të regjimi.

3 pikë	Nëse evidenton tre nga tiparet kryesore në jetën politike të Italisë gjatë regjimit të saj.
2 pikë	Nëse evidenton dy nga tiparet kryesore në jetën politike të Italisë gjatë regjimit të saj.
1 pikë	Nëse evidenton një nga tiparet kryesore në jetën politike të Italisë gjatë regjimit të saj.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29.

Model përgjigjeje

- a)
- 1 shtator 1939. 1 pikë
- b) 2 pikë
- Blloku nazi-fashist ose boshti Berlin – Romë - Tokio (Gjermani, Itali, Japoni etj.)
 - Aleatët e Kombeve të Bashkuara ose Koalicioni Antifashist ,Franca ,Britania e Madhe, SHBA , BRSS etj.
- 3 pikë Nëse përcakton datën e fillimit të luftës si dhe dy blloqet kundërshtarë në këtë luftë.
- 2 pikë Nëse përcakton datën e fillimit të luftës dhe një nga blloqet kundërshtarë OSE dy blloqet kundërshtarë në këtë luftë.
- 1 pikë Nëse përcakton datën e fillimit të luftës OSE një nga blloqet kundërshtarë.
- 0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30

Model përgjigjeje

- a) 1 pikë
- Shteti polak
- b) 2 pikë
- Rruga e protestave popullore të nxitura nga forcat opozitare në këto vende dhe lejimit të zgjedhjeve të lira dhe demokratike.(Poloni , Hungari, Çekosllovakia etj.).
 - Rruga e ndryshimeve të bëra nga forcat reformatore brenda partisë komuniste dhe ndryshimeve politike të bëra nga " lart" nga udhëheqja komuniste. (Bullgari).
- 3 pikë Nëse përcakton shtetin dhe dy rrugët për të rrëzuar komunizmin.
- 2 pikë Nëse përcakton shtetin dhe një nga rrugët për të rrëzuar komunizmin OSE dy rrugët për të rrëzuar komunizmin.
- 1 pikë Nëse përcakton shtetin OSE një nga rrugët për të rrëzuar komunizmin.
- 0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Zgjerimi i pushtetit të Frontit.
- Eliminimi i kundërshtarëve politikë.
- Legalizimi i pushtetit.

- 3 pikë Nëse liston tre nga masat e ndërmara.
- 2 pikë Nëse liston dy nga masat e ndërmara.
- 1 pikë Nëse liston një nga masat e ndërmara.
- 0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Fan Noli erdhi me revolucion në pushtet edhe pse me vizion demokratik amerikan dhe nuk arriti të bënte zgjedhje për të legjitimuar veten në pushtet.
- Fan Noli nuk realizoi të gjithë programin e shpallur të qeverisë që drejtonte.
- Fan Noli nuk bëri reforma radikale dhe ndër to nuk realizoi reformën agrare duke humbur kështu mbështetjen e fshatarësisë.
- Fan Noli kritikoi ashpër Lidhjen e Kombeve për mungesën e dëshirës për të dhënë ndihma ekonomike për Shqipërinë.
- Fan Noli u izolua diplomatikisht nga ndërkombëtarët dhe i vetmi vend me të cilin lidhi marrëdhënie diplomatike ishte Bashkimi Sovjetik. Ky hap e cilësoi atë si politikan me prirje të majta.

- 3 pikë Nëse argumenton tre nga dështimet e Fan Nolit si kryeministër.
- 2 pikë Nëse argumenton dy nga dështimet e Fan Nolit si kryeministër.
- 1 pikë Nëse argumenton një nga dështimet e Fan Nolit si kryeministër.
- 0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33 **4 pikë****Model përgjigjeje**

- Italianët shpallën të rrëzuar monarkinë zogiste dhe Kushtetutën e 1928-ës dhe bënë bashkimin e dy kurorave në një "bashkim personal" në duart e Viktor Emanuelit III. Kushtetuta e re e shtetit u hartua në Itali.
- Gjermanët anuluan këtë bashkim dhe rinjohën pavarësinë e Shqipërisë duke rikthyer monarkinë me në krye Regjencën dhe kushtetutën e vitit 1928. Por kjo do të ishte "pavarësi relative"
- Italianët pasi pushtuan Jugosllavinë, bënë bashkimin e Shqipërisë me Kosovën dhe treva të tjera nën Jugosllavi, duke njohur "Shqipërinë e madhe"
- Gjermanët gjithashtu njohën "Shqipërinë e madhe" të krijuar në kohën e pushtimit

- 4 pikë Nëse krahason dy pushtimet në aspektin e statusit politik që i njohin Shqipërisë dhe të qëndrimit të shqiptarëve jashtë kufirit.
- 3 pikë Nëse krahason dy pushtimet në aspektin e statusit politik që i njohin Shqipërisë (një përgjigje e plotë) dhe të qëndrimit të shqiptarëve jashtë kufirit (përgjigje e pjesshme) ose e kundërta.
- 2 pikë Nëse krahason dy pushtimet në aspektin e statusit politik që i njohin Shqipërisë (një përgjigje e plotë) dhe të qëndrimit të shqiptarëve jashtë kufirit, duke dhënë një përgjigje të pjesshme për të dyja aspektet.
- 1 pikë Nëse nxënësi jep një përgjigje të pjesshme në aspektin e statusit politik që i njohin Shqipërisë OSE një përgjigje të pjesshme në aspektin e qëndrimit të shqiptarëve jashtë kufirit.
- 0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.